

FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS

RREGULLORJA

PËR NDARJEN E TITUJVE SPORTIV TË FEDERATËS
SË SHENJËTARISË

Prishtinë, 11.01.2011

Në bazë të nenit 24 të Statutit të Federatës së SHenjëtarisë Sportive Kosovës, Këshilli drejtues në mbledhjen e vetë të mbajtur më 11.01.2011, në Prishtinë, aprovoi

RREGULLORËN

PËR NDARJEN E TITUJVE SPORTIVË TË FEDERATËS SË SHENJËTARISË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Aprovimi i Rregullorës për ndarjen e titujve sportivë të shenjëtarisë ka për qëllim:

- të mundësoi qasje unike të vlerësimit të rezultateve sportive të shenjëtarëve dhe përcaktimin në titujt gjegjës të sportit të shenjëtarisë,
- të nxisë shenjëtarët në punën sistematike dhe të vazhdueshme në ngritjen profesionale përkryese.

Neni 2

Titujt sportive të shenjëtarisë njëkohësisht janë edhe mënyrë e njohjes shoqërore të shenjëtarëve për mundin e tyre shumëvjeçare dhe rezultatet e arritura të shenjëtarisë.

II. TITUJT SPORTIVE TË SHENJËTARISË

Neni 3

Titujt sportive të shenjëtarisë u ndahen shenjëtarëve të kategorisë seniore. Shenjëtarëve të kategorisë së juniorëve dhe të kadetëve mund të fitojnë titujt e paraparë me këtë Rregullore, nëse arrijnë rezultate që janë paraparë për kategorinë e seniorëve.

- Titullin »shenjëtar i mirë« e ndanë klubi i shenjëtarisë,
- Titullin »shenjëtar i shkëlqyeshëm« dhe »mjeshtër i shenjëtarisë« e ndanë Këshilli drejtues i Federatës Shenjëtarisë Sportive të Kosovës,
- Titullin »mjeshtër republican i shenjëtarisë« dhe »mjeshtër ndërkombëtar i shenjëtarisë« e ndanë Kuvendi I Federatës Sportive të Kosovës.
- Titullin »sportiest i merituar« e ndanë KOK-u.

Neni 4

Titullin një here të ndarë të sportit të shenjëtarisë, shenjëtari e mbanë përjetë.

Neni 5

Shenjëtarëve që fitojnë titujt e paraparë me këtë Rregullore i ndahet edhe diploma dhe shenjëza gjegjëse.

Neni 6

Masat për fitimin e titullit të shenjëtarit sportive, mund të arrihen edhe në dy disiplina të ndryshme.

III. MASAT PËR NDARJEN E TITUJVE TË SHENJËTARIT SPORTIV

Neni 7

Titujt e shenjëtarit sportive ndahen në bazë të normave të plotësuara nga **Tabela e Normave** si në vijim:

1. Titulli »shenjëtar i mire« ndahet për normës e aritur dy here gjatë vitit në garat zyrtare,
2. Titulli »shenjëtar i shkëlqyeshëm« ndahet për arritjen e norms në garat e kupave dhe kampionale.
3. Titulli »mjeshtër i shenjëtarisë« dhe »mjeshtër republican i shenjëtarisë« ndahet për plotësimin e norms nga **Tabela e normave** për garat e nivelit republican dhe ndërkombëtare të cilat janë në Kalendarin e Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës,
4. Titulli »mjeshtër ndërkombëtar i shenjëtarisë« ndahet për plotësimin e norms për këtë titull në Garat ndërkombëtare, Kampionatet Europiane, Botrore, Lojra Olimpikë, Kupa Botrore të parapara me Kalendarin e ISSF-së, ESC-së.
5. Titulli »sportiest i merituar«

IV. REGJISTRIMI I TITULLIT

Neni 8

Regjistrimin e titujve nën pikat III.3. dhe III.4, e udhëheqë Shërbimi profesional i Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës.

V. TITUJT E SPORTISTËVE SHENJËTAR

Neni 9

Titujt e arritur pranohen me Vendimi e Këshillit drejtues në bazë të kërkesës me shkrim të individëve- shenjëtarëve.

VI. TABELA E NORMAVE PËR FITIMIN E TITULLIT

Mëshkujt	Sh.i Mire	Sh. i Shkël.	Mjesh. i shenj	Mjesh. Repub.	Mjesh. Ndërko.	Nor.min. Olimpike
10 m Pushka ajrore 60 diabola	/	558	568	578	580	570
10 m Pushka aj.serike 40 diab.	300	325	355	368	/	
10 m Pushka aj.serike 20 diab.	155	165	/	/	/	
50 m PKVS 60 fish.barkas	/	560	575	585	590	587
50 m PKVS 3X20 fishek	/	1110	1120	1130	1145	1138
50 m PKV serike 3X20 fish.	/	430	485	525	/	
50 m PKV serike 3X10 fishek	/	210	240	/	/	
50 m PKV serike 40 fish.bark.	/	330	345	360	/	
Figura fluturuese – Trap	70	80	100	115	117	
Figura fluturuese - Skeet	70	80	100	115	117	
Figura fluturuese qift – Trap	72	95	105	126	130	
10 m Pistoletë ajrore 60 diabo.	/	550	558	568	575	563
50 m Pistoletë KV 60 fishek	/	518	530	545	554	540
25 m Pistoletë 30+30 fishek	/	545	565	570	575	573
25 m Pistoletë KM 10+10 fish.	139	150	165	175	/	
Femrat						
10 m Pushkë ajrore 40 diabola	/	360	374	382	385	
10 m Pushkë aj.serike 40 diab.	300	326	350	360	/	
10 m Pushkë aj.serike 20 diab.	150	160	/	/	/	
50 m Pushkë st.60 fish. Barkas	/	560	570	580	585	
50 m Pushk.st. 3X20 fishek	/	530	540	560	570	555
50 m Pushkë KV ser.3X20 fish	/	415	470	500	/	
10 m Pistoletë aj. 40 diabola	310	345	358	367	570	365
25 m Pistoletë 30+30 fishek	/	540	555	565	570	
50 m Pushkë KV seri.40 f.bark	/	320	340	360	/	

VËREJTJE: Titullin »sportiest i merituar« e ndanë Komiteti Olimpik i Kosovës.

Prishtinë, 11.01.2011.

KRYETARI I FSHSK-së,
Ali Pllana, ecc i dipl.